



Pranimar / Dorezuar Prilijeno / Predato Received / Delivery	29.04.2021	1	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinita Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Puleg Appendix	Sasia Kohëzina Quantity
SKPM/SHK	2077/2021		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.177/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.177/2021 të datës 23.03.2021, të parashtruar nga grup ankuesish të cilët me autorizim i përfaqësor [] ne adresë banimi: Rezidenca Gjermane, Mati I, Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Komunes së Prishtinës, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 29.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet **jo kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.177/2021 të datës 23.03.2021, të parashtruar nga grup ankuesish të cilët me autorizim i përfaqëson []

A r s y e t i m

Grup ankuesish të cilët me autorizimin i përfaqëson [] si përfaqësuese e përbashkët, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar më datë 23.03.2021 me numër protolli 1326/2021 e regjistruar me numër A.nr.177/2021, kundër Komunes së Prishtinës, për shkak të mos zbatimit të Vendimit Nr.01-0400-970 të datës 21.05.2010 të Kuvendit të Komunes së Prishtinës për dhënien e shujtës ditore për shërbyesit civil të Komunes së Prishtinës si dhe kompensimit retroaktiv të shujtës ditore sipas vendimit Nr.01-0400-970 të datës 21.05.2010 të Kuvendit të Komunes së Prishtinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.03.2021, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses tek Komuna e Prishtinës. Ndërsa Këshilli me datë 22.04.2021 ka pranua nga Komuna e Prishtinës përgjigjen në kërkesë përmes e-maili i cili është protokolluar me numër: 1957/2021, se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 1326/2021 të datës 23.03.2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 22.03.2021 për përfaqësim te përbashkët; Listën e punëtorëve të Bibliotekës "Hivzi Sylejmani" në Prishtinë; Kërkesën e datës 26.01.2021 drejtuar Kryetarit të Komunës së Prishtinës dhe Drejtorit për Financa; Formularin për kërkesë të datës 27.01.2021; Vendimin Nr.01-0400-970 të datës 21.05.2010 të Kuvendit të Komunës së Prishtinës; Vendimin për regjistrimin e Bibliotekës të qytetit të Prishtinës "Hivzi Sylejmani" të datës 04.05.2006; Listën e pagava të muajit shurt të vunitit 2014 për grupit e ankuesve me numër Kodi:10-85006-616-0820; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 29.03.2021; Përgjigjen në kërkesë të datës 22.04.2021; Akt emërimit e ankuesit të datës 25.02.2013; Akt emërimit e ankueses të datës 10.12.2013; Akt emërimit e ankueses të datës 17.09.2013; Akt emërimit e ankuesit të datës 25.02.2013; Akt emërimit e ankueses të datës 25.02.2013; Akt emërimit e ankuesit të datës 25.02.2013; Akt emërimit e ankueses të datës 25.02.2013; Akt emërimit e ankueses të datës 25.02.2013; Akt emërimit e ankueses të datës 25.12.2013; Akt emërimit e ankuesit të datës 25.02.2013; Akt emërimit e ankuesit të datës 25.02.2013; Akt emërimit e ankuesit të datës 25.02.2013; Akt emërimit e ankuesit të datës 25.02.2013; Akt emërimit e ankuesit të datës 25.02.2013; Akt emërimit e ankuesit të datës 25.02.2013; Akt emërimit e ankuesit të datës 25.02.2013; Akt emërimit e ankuesit të datës 25.02.2013; Akt emërimit e ankuesit të datës 25.02.2013; Akt emërimit e ankuesit të datës 25.02.2013; Akt emërimit e ankuesit të datës 25.02.2013; Akt emërimit e ankuesit të datës 01.08.2013; Akt emërimit e ankuesit të datës 25.02.2013; Akt emërimit e ankuesit të datës 21.05.2013; Akt emërimit e ankuesit të datës 25.02.2013; Akt emërimit e ankuesit të datës 25.02.2013; Akt emërimit e ankueses të datës 25.02.2013; Akt emërimit e ankueses të datës 25.02.2013; Kërkesa e datës 23.08.2019 dërguar Kryetarit të Komunës së Prishtinës dhe Drejtorit të Financave.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.177/2021 të datës 29.03.2021, të parashtruar nga grup ankuesish të cilët i përfaqëson.

sepse:

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, Kolegji ka konstatuar se grup ankuesish të përfaqësuar nga sipas autorizimit të datës 22.03.2021, që të gjithë janë të punësuar në Komunën e Prishtinës në Bibliotekën "Hivzi Sylejmani" sipas të dhënave në vijim: sipas Akt Emërimit të datës 25.02.2013 është i punësuar në pozitën Drejtor i Bibliotekës, sipas Akt Emërimit të datës 10.12.2013 është e punësuar në pozitën "shefe-nëpunese profesionale e nivelit drejtores", sipas Akt Emërimit të datës 25.02.2013 është e punësuar në pozitën "Sekretare në Bibliotekë", sipas Akt Emërimit të datës 25.02.2013 është e punësuar në pozitën "bibliotekare", sipas Akt Emërimit të datës 25.02.2013 është e punësuar në pozitën "biblotekare", sipas Akt Emërimit të datës 25.02.2013 është i punësuar në pozitën "librar i lartë & IT", sipas Akt Emërimit të datës 25.02.2013 është i punësuar në pozitën "librare e lartë", sipas Akt Emërimit të datës 25.02.2013 është e punësuar në pozitën "librare", sipas Akt Emërimit të datës 25.02.2013 është e punësuar në pozitën "librare", sipas Akt Emërimit të datës 25.02.2013 është i punësuar në pozitën "librar"

sipas Akt Emërimit të datës 25.02.2013 është e punësuar në pozitën "librare" sipas Akt
 Emërimit të datës 25.02.2013 është i punësuar në pozitën "librar" sipas Akt
 Emërimit të datës 25.02.2013 është e punësuar në pozitën "librare", sipas Akt Emërimit
 të datës 25.02.2013 është i punësuar në pozitën "librar", sipas Akt Emërimit të datës
 25.02.2013 është e punësuar në pozitën "librar", sipas Akt Emërimit të datës 25.02.2013
 është e punësuar në pozitën "librare", sipas Akt Emërimit të datës 25.02.2013 është
 i punësuar në pozitën "librar", sipas akt emërimit të datës 25.02.2013 është punësuar në
 bibliotekën "Hivzi Sylejmani" në pozitën "librar" sipas Akt Emërimit të datës 25.02.2013
 është i punësuar në pozitën "librar", sipas Akt Emërimit të datës 25.02.2013 është e
 punësuar në pozitën "librare" sipas Akt Emërimit të datës 25.02.2013 është e punësuar
 në bibliotekën në pozitën "librare", sipas Akt Emërimit të datës 25.02.2013 është i
 punësuar në pozitën "roje", sipas Akt Emërimit të datës 21.05.2013 është i punësuar në
 pozitën "librar", sipas Akt Emërimit të datës 25.02.2013 është i punësuar në pozitën
 "roje", sipas Akt Emërimit të datës 25.02.2013 është i punësuar pozitën "roje",
 sipas Akt Emërimit të datës 25.02.2013 është e punësuar në pozitën "pastruese",
 sipas Akt Emërimit të datës 25.02.2013 është e punësuar në pozitën "pastruese".

Sipas shkresave të lëndës Kolegji ka gjetur se Biblioteka "Hivzi Sylejmani" vepron në kuadër të Drejtorisë për Kulturë të Komunës së Prishtinës.

Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 2 paragrafin 4 dhe 6 ku është përcaktuar se: **Nëpunës i Shërbimit Publik** - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike", **6.Nëpunës administrativo-teknik-dhe mbështetës** është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publik si dhe mbështetur në nenin 3 të Ligjit Nr.04/L-097 për Bibliotekat ku është përcaktuar se Bibliotekat janë institucione kulturore, arsimore dhe informuese, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave konstaton se grup ankuesish të punësuar në Bibliotekën "Hivzi Sylejmani" nuk janë nëpunës civilë përkatësisht të njëjtit hynë në kategorinë e nëpunësve të shërbimit publik dhe në kategorinë e nëpunësve administrativo teknik-mbështetës.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civilë si dhe duke marr parasysh konstatimin se grup ankuesish kanë statusin e nëpunësve të shërbimit publikë dhe nëpunësve administrativo-teknik dhe mbështetës, rezulton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.177/2021 të datës 23.03.2021, të parashtruar grup ankuesish e të cilët me autorizim i përfaqëson si përfaqësuese e përbashkët.

Në vështrim të nenit 64 dhe 82 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, marrëdhënia e punës e nëpunësve të shërbimit publikë si dhe nëpunësve administrativo-teknik dhe mbështetës i nënshtrohet



legislacionit të punës, andaj pas konstatimit se Këshilli nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e grup ankuesve, Kolegji udhëzon palën ankuese për ushtrimin e mjeteve juridike në pajtim me nenin 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: *Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.*


Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.177/2021

Flakron GASHI



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- përfaqësues e përbashkët sipas autorizimit (grup ankuesish);
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

